



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:144142

Datë: 03.04.2024

Numri i dokumentit: 05538449

P.nr. 1807/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti i Përgjithshëm –Divizioni Penal, gjyqtari Sabit Sadikaj, me bashkëpunëtorin profesional Asdren Selmani, në çështjen penale ndaj të pandehurit, F.F për shkak të veprës penale “Blerje, pranimi ose fshehje e sendeve të përfituara nga vepra penale”, nga neni 333 par. 2 të KPK-së. i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.2609/22 e datës 05.07.2022, në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë: 15.03.2024, ku në prezencë të prokurores së shtetit Nebahate Salihu, si dhe të pandehurit F.F kurse me datë: 19.03.2024, mori dhe shpalli, ndërsa me datë: 25.03.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

F.F i biri i A, i lindur me “data e lindjes”, në “Vendlindja”, tani me vendbanim në rrugën, në Lagjen “lagja” i martuar i punësuar, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr. personal “leternjoftim”, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

S e p s e:

Me dt.30.08.2021, rreth orës 20:04, në lagjen Ulpiana në Prishtinë, saktësisht në lokalit mobil shop “F---”, i pandehuri F.F si pronar i këtij lokali nga një person i panjohur kishte blerë telefonin Iphone 11 për çmimin prej 500 euro, pronë e të dëmtuarit N/G, të cilit paraprkasht në të njëjtën ditë ky telefon ju kishte vjedhur në Glllogovc, edhe pse në bazë të çmimit i pandehuri e ka ditur apo ka mund ta ketë ditur se është i përfituar në mënyrë të kundërligjshme, të cilin telefon më pas ja kishte shitur I R pronar në mobil shop “I----”, në Mitrovicë, në vlerë prej 520 euro (pesëqind e njëzet euro).

- me këtë i pandehuri F.F ka kryer veprën penale Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 333 par. 2 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit të lartcekur dhe neneve 4, 7, 17, 38, 39, 40, 42, 43, 44, 69, 70, dhe nenit 248 të KPRK-së dhe neneve, 242 par.2, 358, 364 dhe 365 të KPPRK-së, të akuzuarin e gjykon me:

## DENIM ME BURGM ZEVENDESOHET ME DENIM MË GJOBË

- I. Të akuzuarit F.Fi shqiptohet dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim, konform nenit 44 par.1 të KPRK-së, me pëlqimin e personit të dënuar, dënimi me burgim, i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 1000 (njëmijë) euro, i cili dënim duhet të paguhet brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita kur aktgjykimi merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.
- II. Pala e dëmtuar, N.G, më vendbanim në rr, “rruga”, nr. ----, në Prishtinë, lidhur me kërkesën pasurore juridike, udhëzohen në kontest të rregullt juridiko civil.
- III. Obligohet i akuzuari që t’i paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës penale, ashtu që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20.00 (njëzet) Euro, në emër të taksës për programin e kompensimit të viktimave të krimit shumën prej 20.00 (njëzet) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

## A R S Y E T I M

### Rrjedha e procedurës, Historiku:

Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.2609/22 e datës 05.07.2022, kundër të pandehurit F.F për shkak të veprës penale “Blerje, pranimi ose fshehje e sendeve të përfituara nga vepra penale”, nga neni 333 par. 2 të KPK-së.

### Kompetenca e gjykatës:

Gjykata para se të caktoj shqyrtimin fillestar, në vështirim të aktakuzës, ka vlerësuar sipas detyrës zyrtare çështjen e kompetencës territoriale dhe të asaj lëndore.

Sa i përket kompetencës territoriale, gjykata vlerëson se në kuptim të nenit 29 paragrafi 1 i KPPRK-së, kompetencë territoriale për të gjykuar një çështje juridiko-penale ka gjykata në territorin e së cilës është kryer ose është tentuar të kryhet vepra penale, apo gjykata në territorin e së cilës është shkaktuar pasoja. Në rastin konkret, vepra penale është kryer në Prishtinë, andaj Gjykata Themelore në Prishtinë ka kompetencën territoriale në gjykimin e kësaj çështje.

Duke vlerësuar kompetencën lëndore, gjykata konsideron se me qenë se për veprën penale “Blerje, pranimi ose fshehje e sendeve të përfituara nga vepra penale”, nga neni 333 par. 2 të KPK-së. parashihet dënim me burgim deri në një (1) vit, po ashtu meqenëse e njëjta vepra nuk është paraparë me nenin 22 të KPPRK-së, atëherë gjykata konstaton se departamenti i përgjithshëm ka kompetencën lëndore për gjykimin e kësaj çështje.

### Shqyrtimi fillestar:

Gjykata pas analizimit të aktakuzës ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar me datë: 15.03.2024, ku morën pjesë, Prokurorja e shtetit Nebahate Salihu, si dhe i akuzuari F.F.

I pandehuri F.F në seancën e shqyrtimit fillestar, ka deklaruar duke theksuar se: për këtë rast pranoj se jam fajtor, për arsye se nuk i kishte marrur dokument dhe nuk i kishte kërkuar marrjen e dokumentit, personit prej të cilit i kishte bere blerjen, po ashtu i ka propozuar gjykatës, qe me rastin e shqiptimit të dënimit, të i zëvendësohet në dënim me gjobë.

Prokurorja e Shtetit, Nebahate Salihu në seancën e shqyrtimit fillestar, lidhur me pranimin e fajësisë nga i akuzuari, deklaroi: Nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pasi që pranimi i fajësisë ishte bërë në mënyre vullnetare dhe i bazuar në prova të cilat gjenden në shkresat e lendes, po ashtu i ka propozuar gjykatës qe të merr si rrethanë lehtësues pranimin e fajësisë, ndërsa si rrethana renduese të i merr ato të cilat janë të parapara me ligj.

#### Vlerësimi mbi pranimin e fajësisë:

Andaj pas pranimin të fajësisë nga i pandehuri dhe deklarimit të Prokurorit të Shtetit, gjykata me Aktvendim pranoi pranimin e fajësisë nga i pandehuri, pasi që është bindur plotësisht se ishte i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë. Pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe ka mbështetje në provat tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe se nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 248 paragrafi 1 të KPPRK-së. Mbi këtë bazë, gjykata vlerëson se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara në dispozitën e nenit 242 par.2 të KPPRK-së, lidhur me pranimin e fajësisë.

#### Vlerësimi i gjykatës lidhur me elementet e veprës penale:

Se i akuzuari F.F me dt.30.08.2021, rreth orës 20:04, në lagjen Ulpiana në Prishtinë, saktësisht në lokalitetin mobi shop “F----”, i pandehuri F.F si pronar i këtij lokali nga një person i panjohur kishte blerë telefonin Iphone 11 për çmimin prej 500 euro , pronë e të dëmtuarit N.G, të cilit paraprakisht në të njëjtën ditë ky telefon ju kishte vjedhur në Gllogovc, edhe pse në bazë të çmimit i pandehuri e ka ditur apo ka mund ta ketë ditur se është i përfituar në mënyrë të kundërligjshme , të cilin telefon më pas ja kishte shitur te pronari në mobi shop “I-----”, në Mitrovicë, në vlerë prej 520 euro (pesëqind e njëzet euro). Gjykata nga deklarimi i të akuzuarit në shqyrtimin fillestar dhe nga pranimi i fajësisë nga ana e tij, si dhe deklarimi i prokurorit, duke e pranuar, pranimin e fajësisë, po ashtu nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, u vërtetua se i njëjti me datë, kohë dhe vend si në dispozitivin e aktakuzës së ngritur ndaj tij, ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata ka konstatuar se janë përmbushur elementet e veprës penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës, kjo për faktin se me veprimet e tij të përshkuara si në aktakuzë, ka përvetësuar në mënyrë të kundërligjshme pasurin e huaj.

#### Shqiptimi i sanksionit penale:

Me rastin e matjes së dënimit gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat të cilat konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si rrethana lehtësuese për të pandehurin gjeti se i njëjti e ka pranuar fajësinë që në seancën e shqyrtimit fillestar, pendimin lidhur me veprën e kryer, Gjykata vlerëson se dënimi i shqiptuar në rastin konkret

është i drejtë dhe i ligjshëm, në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale dhe intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, pas që i akuzuari në lokalitetin ku i njëjti punon, edhe pse e ka ditur apo ka mundur ta dijë, ka blerë, nga një person i panjohur telefonin e markës Iphon 11 për çmimin prej 500.-€, ashtu siç është përshkruar në aktakuzën e cila i vihet në barrë për veprën penale “Blerje, pranimi ose fshehje e sendeve të përfituara nga vepra penale”, nga neni 333 par. 2 të KPK-së. Të akuzuarit i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim, konform nenit 44 par.7 të KPRK-së, me pëlqimin e personit të dënuar, dënimi me burgim, i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 1000 (njëmijë) euro, i cili dënim duhet të paguhet brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita kur aktgjykimi merr formën e prerë.

#### Qëllimi i shqiptimit të dënimit:

Po ashtu, gjykata vlerëson se një dënim i tillë do të i arri qëllimin e dënimit, pasi që do të ndikojë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprës penale në të ardhmen, si dhe në rehabilitimin e tij, në parandalimin e personave tjerë nga kryerja e veprës penale, si dhe në shprehjen e gjykimit shoqëror në raport me veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit në shoqëri, duke ndikuar në këtë mënyrë në përmbushjen e qëllimit të dënimit, të paraparë në nenin 38 të KPRK-së.

#### Vendimi mbi udhëzimin e palës në kontest të rregullt juridiko-civil:

Vendimin lidhur me udhëzimin në palës së dëmtuar në kontest juridiko civil është mbështetur në nenin 462 par 2 të KPPRK-së. ku nga paragrafi 2. Citohet se: *“Në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pasurore juridike të dëmtuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontest civil. Kur të dhënat e mblidhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që tërë kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në kontest civil apo të paraqes kërkesë në Programin për Kompensim të Viktimave nëse i plotëson kushtet e atij programi”*, andaj gjykata mbi bazën e kësaj e ka udhëzuar palën në kontest të rregullt juridiko-civil.

#### Vendimi mbi kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale:

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, u mor në bazë të nenit 452, par. 1, dhe par.2 të KPPRK-së. ku nga paragrafi 1.citohet se: *Kur gjykata e shpall të akuzuarin fajtor, me aktgjykim vendos se detyrohet t'i kompensojë shpenzimet e procedurës penale.*

#### Baza ligjore mbi të cilën u vendos sipas këtij aktgjykimi:

Nga sa u tha më lart, dhe në bazë të nenit 4, 7, 17, 38, 39, 42, 43, 44, 69, 70 dhe 333 të KPRK-së, si dhe neneve, 242 par.2, 358, 364, 365, 452, 462, të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINE  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

**2022:144142, 03.04.2024**

Bashkëpunëtori profesional:

Asdren Selmani

---

Gjyqtari:

Sabit Sadikaj

---

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.